

VENDIM
Nr.282, datë 4.7.1997

PËR SHPALLJEN OBJEKT TË RËNDËSISHËM SHTETËROR TË PALLATIT TË
KONGRESEVE

Në mbështetje të nenit 3 germa a të ligjit nr.7550, datë 20.1.1992 “Për policinë e objekteve”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Deri në përfundim të procesit zgjedhor, objekti “Pallati i Kongreseve”, ku zhvillon aktivitetin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shpallet objekt i rëndësishëm shtetëror.
2. Ministria e Brendshme të marrë menjëherë masat e nevojshme për ruajtjen e objektit. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino